

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6678  
E shtunë, 13 gusht 2022  
çmimi 0.40

Hamza viziton liderët e UÇK-së në Hagë: Askush s'mund ta njollosë luftën çlirimtare | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VAZHDON DEBATI PARA TAKIMIT TË 18 GUSHTIT NË BRUKSEL | FAQE 4-5

## PAS DEKLARATËS SË KURTIT PËR LUFTË, HOXHAJ I BËN THIRRJE TA Mbledhë KUVENDIN NËSE SITUATA ËSHTË SERIOZE



Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti për deklaratat e tij për luftë me Serbinë. Duke iu referuar takimit të 18 gushtit me Vuçiqin në Bruksel, Hoxhaj e ka pyetur Kurtin se çfarë kuptimi ka dialogu dhe diplomacia në tavolinë kur në terren po

kërcënohemi me luftë. Në këtë kontekst, Hoxhaj i ka bërë thirrje Kurtit të thërrasë urgjentisht mbledhje të Kuvendit nëse ka informacione serioze për luftë. Ndërsa Kurti të premten nuk ka folur për luftë, por ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të përfundojë me njohje reciproke

## SHQIPËRIA E DORËZON NË KE REZOLUTËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

Republika e Shqipërisë ka dorëzuar në Këshillin e Evropës (KE) rezolutën kundër raportit të Dick Martyt. Nota verbale që është dorëzuar në KE mban pohimin se pretendimet e raportit të Martyt për trafikim të organeve gjatë luftës në Kosovë nuk janë vërtetuar asnjëherë dhe kësajoh kërkohet që të hedhet poshtë ky raport, mbi bazën e të cilit është krijuar Gjykata Speciale

FAQE 3



## AKTUALE




PRESIDENTI I SHQIPËRISË TË HËNËN VIZITON KOSOVËN | F. 5

SHEFI I NATO-S JAVËN E ARDHSHE TAKOHET ME KURTIN DHE VUÇIQIN | F. 7

TË RINJTË E KOSOVËS PROTESTOJNË ME VALIXHE: KUR BOHET MIRË? | F. 7

FAMILJA DEHARI KËRKON PËRJASHTIMIN E PROKURORIT SHEFKIU | F. 2

## EKONOMI



KURTI LAVDËRON PUNËN E DREJTUESVE TË DOGANËS: TË HYRAT U RRIËN PËR 14 PËR QIND | F. 8

TRANSFEROHEN 9 000 LËNDË TË BIZNESEVE NË GJYKATËN KOMERCIALE, NË SHTATOR SEANCAT E PARA | F. 8

## SPORT

DRITA, SYNIME TË MËDHA NË KAMPIONATIN E RI | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Zelensky u kërkon zyrtarëve ushtarakë të mos flasin publikisht për taktikat ushtarake

KIEV, 12 GUSHT - Presidenti ukrainas u ka bërë thirrje zyrtarëve që të mos flasin më me gazetarët për taktikat ushtarake kundër Rusisë, teksa një zjarrtar e lartë e Ministrisë së Mbrojtjes ka thënë se është hapur një hetim lidhur me rrjedhjen e informacioneve. Deklaratat e Volodymyr Zelenskyt vijjnë teksa spekulimet po vazhdojnë lidhur me shkakun e një serie shpërthimesh më herët gjatë kësaj jave në bazën ajrore ruse në Krimenë e okupuar. Shpërthimet kanë shkatërruar të paktën tetë avionë luftarakë rusë që ishin në bazën ajrore në Krimë. Imazhet satelitore kanë shfaqur shkatërrim të madh në bazën ajrore Saki që gjendet në

perëndim të qytetit Novofedorivka të Krimesë. Rusia ka sugjeruar se shpërthimet kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë. Megjithatë, zyrtarë të pidentifikuar ukrainas u kanë thënë medieve amerikane se forcat ukrainase janë përgjegjëse për shpërthimet. “Nuk është koha për gjëra të kota dhe për deklarata të zëshme. Sa më pak detaje të zbuloni për planet tona të mbrojtjes, aq më mirë do të jetë për zbatimin e atyre planeve”, ka thënë Zelensky. Zelensky ka thënë se publikimi i taktikave ushtarake është veprim i papërgjegjshëm. “Nëse dëshironi që Ukraina të fitojë duhet të jeni të vetëdijshëm se jeni përgjegjës për çdo fjalë që



thoni për planet e qeverisë sonë për mbrojtje apo kundërsulme”, ka thënë ai. Në “Facebook”, zëvendësministrja e Mbrojtjes, Hanna Malyar, ka thënë se shërbimet e sigurisë po hetojnë se kush ka folur për mediet lidhur me shpërthimet. “Rrjedhje të tilla të

informacionit pengojnë planet e ushtrisë ukrainase, pasi që armiku mund t'i ndryshojë veprimet e tij dhe të përdorë këtë informacion kundër nesh”, ka thënë ajo. Ndërsa Turqia ka thënë se edhe dy anije me drithëra janë larguar nga portet ukrainase në Detin e Zi më 11 gusht, duke

bërë që totali i anijeve që janë larguar nga Ukraina të arrijë në 14.

Ukraina ka arritur marrëveshje me Turqinë dhe Kombet e Bashkuara më 22 korrik për ta zhbllokuar eksportin e 22 milionë tonë mistri dhe drithërave të tjera që kishin mbetur në porte dhe depo, qëkur Rusia nisi pushtimin e shtetit më 24 shkurt.

Ukraina është një eksportuese e madhe e grurit, misrit dhe drithërave të tjera dhe pamundësia për t'i eksportuar këto produkte ka kontribuar në rritjen e çmimeve të ushqimit në mbarë botën. Rritjet e çmimeve kanë rritur frikën se disa shtete mund të preken nga uria ose mund të shkaktohet jostabilitet politik.

## Trumpi nuk do ta kundërshtojë vendimin për bastisjen e shtëpisë së tij në Florida



WASHINGTON, 12 GUSHT - Ish-presidenti i SHBA-së, Donald Trump, ka thënë se nuk do ta kundërshtojë lëshimin e urdhrin që lejoi agjentët e FBI-së ta kontrollojnë shtëpinë e tij në Mar-a-Lago. Trumpi ka thënë se ai po inkurajonte “lejimin e menjëhershëm” të tij, por përsëriti pretendimet se kërkimi ishte i panevojshëm dhe i motivuar politikisht. Departamenti Amerikan i Drejtësisë i ka bërë një kërkesë të rrallë një gjykatë të Floridës për ta liruar urdhrin. Nëse jepet, kjo do të thotë se dokumentet janë vënë në dispozicion të publikut,

raporton “BBC”. Kërkimi i FBI-së besohet të jetë i lidhur me një hetim nëse ish-presidenti hoqi të dhënat e klasifikuara dhe materialet e ndjeshme nga Shtëpia e Bardhë. Sipas “Washington Post”, duke cituar burime anonime, dokumentet në lidhje me armët bërthamore ishin ndër sendet që agjentët e FBI-së po kërkonin në Mar-a-Lago. Burimet nuk i kanë thënë gazetës nëse informacioni përfshinte armë amerikane apo të ndonjë kombi tjetër. Trumpi kishte një afat kohor deri në orën 15:00 të premtën për ta kundërshtuar vendimin,

por nuk është e qartë se çfarë do të thotë deklarata e tij tani kur dokumentet mund të publikohen. “Jo vetëm që nuk do të kundërshtoj lëshimin e dokumenteve që lidhen me bastisjen dhe thyerjen joamerikane, të pajustificuar dhe të panevojshme të shtëpisë sime në Palm Beach, Florida, Mar-a-Lago, por po shkoj një hap më tej duke kërkuar menjëherë, publikimin e atyre dokumenteve”, është thënë në deklaratë. Agjentët e FBI-së gjatë bastisjes në Mar-a-Lago kishin kërkuar që kamerat të fikeshin, por ekipi i Trumpit refuzoi të pajtohej, sipas “CBS News”.

## Sekretari britanik: Pushtimi rus i Ukrainës ka dështuar

LONDËR, 12 GUSHT - Sekretari britanik i Mbrojtjes, Ben Wallace, ka thënë se Vladimir Putini tani nuk ka gjasa të ketë sukses në pushtimin e Ukrainës. Wallace ka thënë se pushtimi rus i Ukrainës kishte “dështuar”, pasi ai ka premtuar më shumë mbështetje financiare dhe ushtarake për mbrojtjen e kombit të Evropës Lindore. Danimarka i është bashkuar Mbretërisë së Bashkuar për ofrimin e më shumë ndihme për Ukrainën në një konferencë në Kopenhagë, të bashkorganizuar nga Wallace. “Presidenti Putin do të ketë

luajtur bixhoz që në gusht. Pas disa muajsh të gjithë do të jemi mërzitur nga konflikti dhe komuniteti ndërkombëtar do të ketë shkuar në drejtime të ndryshme. Epo, dita e sotme është dëshmi e të kundërtës. Ne kemi dalë nga ky takim me më shumë premtime për financa, më shumë premtime trajnimi dhe më shumë premtime për ndihmë ushtarake, të gjitha të krijuara për ta ndihmuar Ukrainën të fitojë, për ta ndihmuar Ukrainën të ngrihet për sovranitetin e saj dhe në të vërtetë për të siguruar që ambicet e presidentit Putin të dështojnë në Ukrainë”, ka



thënë Wallace. Sekretari i Mbrojtjes ka thënë se ishte e rëndësishme të kuptohet se luftimet dhe

humbjet e jetëve po ndodhin ende, por ka shtuar se Rusia “po fillon të dështojë në shumë fusha”, raporton “The

Guardian”. Ai ka thënë se rusët kanë dështuar deri më tani dhe nuk ka gjasa të kenë sukses ndonjëherë në pushtimin e Ukrainës. “Pushtimi i tyre (rusëve) ka dështuar dhe është rimodifikuar vazhdimisht në masën që ata me të vërtetë janë duke u fokusuar vetëm në pjesë të jugut dhe në lindje, një rrugë e gjatë e shumë larg operacionit të tyre të ashtuquajtur special treditur”, ka thënë ai. Siç ka thënë ai, tri ditë janë tashmë mbi 150 ditë dhe gati gjashtë muaj, me humbje të mëdha të konsiderueshme të pajisjeve dhe të personelit rus.

# Shqipëria e dorëzon në KE rezolutën kundër raportit të Dick Martyt

Republika e Shqipërisë ka dorëzuar në Këshillin e Evropës (KE) rezolutën kundër raportit të Dick Martyt. Nota verbale që është dorëzuar në KE mban pohimin se pretendimet e raportit të Martyt për trafikim organesh gjatë luftës në Kosovë nuk janë vërtetuar asnjëherë dhe kësajsoj kërkohet që të hedhet poshtë ky raport, mbi bazën e të cilit është krijuar Gjykata Speciale

EPOKA  
ERE

FATON DËRMAKU

TIRANË, 12 GUSHT - Shqipëria e ka dorëzuar në Këshillin e Evropës (KE) rezolutën kundër raportit të Dick Martyt për pretendimet e pabaza për tregtinë e jashtëligjshme të organeve të njeriut në Kosovë dhe Shqipëri e cila është aprovuar në Kuvendin shqiptar më 21 korrik.

Nota verbale, e cila i është bashkëngjitur rezolutës, përmban pohimin se pretendimet nga raporti i Dick Martyt, edhe pas 10 vjetësh hetim, nuk janë vërtetuar dhe nuk janë të bazuara në fakte. "Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës shpreh

komplimentet për përfaqësitë e përhershme të vendeve anëtare dhe vëzhguesit në Këshillin e Evropës dhe ka nderin të informojë se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi më 21 korrik 2022 Rezolutën për pretendimet e pabaza për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri", është thënë në shënim. Më tutje, në këtë notë verbale është thënë se rezoluta që i bashkëngjitet notës është përgjigje ndaj Rezolutës 1782 (2011) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, "Hetimi i akuzave për trajtim çnjerëzor të njerëzve dhe tregti ilegale me organe njerëzore në Kosovë", i cili bazohet në raportin (Dokumentin 12462, datë

7 janar 2011) nga Dick Marty. "Sipas rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 21 korrik 2022, pretendimet e bëra në raportin e Dick Martyt për vrasjen e njerëzve me qëllim mbledhjen dhe shitjen e organeve të tyre dhe tregtinë e paligjshme të organeve të njeriut në Shqipëri dhe Kosovë, të cilat janë të listuara në paragrafët 1 dhe 4 të Rezolutës 1782 të KSBE-së (2011), pas më shumë se dhjetë vjetësh hetime të thelluara nga Forca Speciale Hetimore e BE-së dhe pasardhësi i saj, Zyra e Prokurorit të Specializuar, mbeten të pagjetura, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte dhe për këtë arsye duhen parë si të tilla nga të gjitha institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare",

është thënë në shënim.

Po në notën verbale të misionit të Shqipërisë në KE është thënë se rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë kërkon që Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës të bëjë një raport pasues dhe ta rishikojë Rezolutën 1782 (2011), duke rivlerësuar akuzat për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/ose Kosova. "Në dritën e zhvillimeve të ndodhura gjatë dekadës së fundit, fakte, prova dhe informacione të përditësuara, duke marrë parasysh edhe angazhimin, vullnetin dhe bashkëpunimin e plotë të Shqipërisë dhe Kosovës në shërbim të së vërtetës dhe vendosjes së drejtësisë. Misioni i përhershëm e Shqipërisë kërkon nga përfaqësitë e përhershme të shteteve anëtare dhe vëzhguesit në Këshillin e Evropës që t'ua përcjellin organeve të tyre kompetente shtetërore Rezolutën mbi akuzat e pabaza për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri. Misioni i Përhershëm i Shqipërisë

në Këshillin e Evropës e përdor këtë mundësi për t'i përsëritur shprehjet e respektit të thellë ndaj përfaqësive të përhershme të shteteve anëtare dhe shteteve vëzhguese të Këshillit të Evropës" është thënë në notën shqiptare. Me 125 vota për dhe asnjë abstenim, deputetët e pranishëm në seancën e Kuvendit të Shqipërisë më 21 korrik kanë miratuar rezolutën kundër akuzave për trafikim të organeve në Kosovë dhe Shqipëri gjatë luftës në Kosovë.

Gjykata Speciale është krijuar mbi bazën e raportit të Dick Martyt, ku nga nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Përpos tyre, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala.



## Hamza viziton liderët e UÇK-së në Hagë: Askush s'mund ta njollosë luftën çlirimtare

HAGË, 12 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka vizituar të premtën liderët e UÇK-së në Hagë. Ai ka thënë se të gjithë luftëtarët e lirisë që janë në Haga ishin mirë me shëndet. Hamza ka thënë se luftës së drejtë të UÇK-së askush nuk do të mund t'i vë njollë. "Sot, në Hagë, pata

një ndër vizitat më emocionale të jetës time. Takova Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. Aty takova edhe Rexhep Selimin dhe Hysni Gucatin. Të gjithë ushtarët e lirisë ishin mirë. Lufta mbrojtëse e popullit të Kosovës ishte e drejtë dhe e pastër andaj kurrë më krenarë se sot nuk i pashë edhe në

këtë betejë të tyre. Me besimin e pathyer që shumë shpejt do të jenë pranë nesh, të lirë siç u takon, u çmallëm e folëm gjerë e gjatë për Kosovën që aq shumë e duan. Luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do të mund kurrë askush t'i vë damkë", ka shkruar Hamza në "Facebook".





VAZHDON DEBATI PARA TAKIMIT TË 18 GUSHTIT NË BRUKSEL

## Pas deklaratës së Kurtit për luftë, Hoxhaj i bën thirrje ta mbledhë Kuvendin nëse situata është serioze

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti për deklaratat e tij për luftë me Serbinë. Duke iu referuar takimit të 18 gushtit me Vuçiqin në Bruksel, Hoxhaj e ka pyetur Kurtin se çfarë kuptimi ka dialogu dhe diplomacia në tavolinë kur në terren po kërcënohemi me luftë. Në këtë kontekst, Hoxhaj i ka bërë thirrje Kurtit të thërrasë urgjentisht mbledhje të Kuvendit nëse ka informacione serioze për luftë. Ndërsa Kurti të premten nuk ka folur për luftë, por ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të përfundojë me njohje reciproke

**EPOKA  
ERE**

Lirim GECI

**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, i ka reaguar kryeministrin Albin Kurti për deklaratat e tij për luftë, duke thënë se nëse situata qenka serioze, kryeministri duhet ta thërrasë Kuvendin dhe të japë shpjegim publik.

Hoxhaj, ish-ministër i Punëve të Jashtme, përmes një statusi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se gjatë kësaj jave kryeministri Kurti dy herë ka folur për një luftë të mundshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Gjatë kësaj jave kryeministri Kurti dy herë foli për një luftë të mundshme mes Kosovës dhe

Serbisë! Javën tjetër Kurti takohet me Vuçiqin në Bruksel! Çfarë kuptimi ka dialogu dhe diplomacia në tavolinë kur në terren po kërcënohemi me luftë? Nëse situata qenka kaq serioze, atëherë do të duhej të mbledhet Kuvendi dhe jo të shkojë kryeministri në Bruksel", ka shkruar Hoxhaj.

Po ashtu, ai ka thënë se nëse ka ndonjë sinjal për ndonjë situatë serioze, Kurti duhet ta njoftojë opozitën dhe partnerët. "Nëse nuk është reale mundësia e luftës, atëherë kush investon në një Kosovë nëse është në gjendje luftime? Kush e njih më? Si mund të anëtarësohet Kosova në organizata ndërkombëtare? Rrëfimi për Kosovën shtet në prag luftime aq shumë po dëmton

vendin sa që ta tejkalojë imagjinatën e Kurtit. Por, nëse situata është serioze, kryeministri Kurti duhet të japë shpjegim publik dhe informim politik neve, deputetëve të Kuvendit", ka shkruar Hoxhaj. Më tutje, Hoxhaj ka thënë se nëse Kurti dhe presidentja Vjosa Osmani kanë formacione të besueshme se ka rrezik për luftë duhet të thërrasin mbledhje urgjente të Kuvendit të Kosovës. "Sipas Kushtetutës, kryeministri dhe presidenti i Republikës kanë për detyrë ta thërrasin mbledhjen urgjente të Kuvendit të Kosovës çdoherë kur kanë informacione të besueshme se ka rrezik të drejtpërdrejtë për luftë dhe konflikt të armatosur, kur rrezikohet siguria dhe

mbrojtja e vendit, jeta dhe prona e qytetarëve. Çfarë mënyre komunikimi është kjo e parisë institucionale kur flet për luftë e nuk zbaton detyrat kushtetuese që kanë ndaj vendit dhe qytetarit?", ka shkruar Hoxhaj.

**Kurti: Kur Serbia flet për vrasje e dhunë, flet për vete, jo për Kosovën**

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të enjten nuk ka folur për luftë, por ka thënë se kur zyrtarët në Beograd, përfshirë presidentin serb Aleksandër Vuçiq, flasin për dhunë dhe vrasje në Kosovë, ata flasin për vete, "flasin për imagjinatën e mendimet e tyre". Ky reagim i Kurtit vjen një ditë pasi presidenti Vuçiq, ka deklaruar në Beograd se ka informacione për plane se në veri të Kosovës po përgatitet "likuidimi i popullit tonë", duke iu referuar popullsisë serbe që jeton në Kosovë.

Por, Kurti ka thënë se Kosova është për paqe dhe stabilitet. "Kur ata flasin, nuk janë duke folur për ne, por për vete. Ne jemi për paqe, siguri, stabilitet

afatgjatë dhe duhet që me shtetin tonë jo vetëm ta mbrojmë sovranitetin dhe integritetin territorial, por edhe demokracinë, kushtetutshmërinë, sundimin e ligjit dhe progresin", ka thënë Kurti.

Ai sërish e ka akuzuar Serbinë se ka nxitur rritjen e tensioneve në veri të Kosovës më 31 korrik dhe 1 gusht, kur serbët lokalë, duke shprehur pakënaqësinë e vendimeve të Kosovës për targar dhe dokumentet serbe, bllokuan rrugët në veri.

"Dita e 1 gushtit do të shkonte tërësisht paqësore dhe do të ishte dita e parë e punës së muajit të tetë të vitit, mirëpo më 31 korrik u ngritën ato barrkada prej njerëzve që kishin nxitur, planifikuar, përgatitur e financuar strukturat ilegale që u bënë banda kriminale nëpër rrugën në veri të Kosovës", ka thënë Kurti gjatë vizitës në Doganën e Kosovës.

Duke komentuar takimin me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, që do të mbahet më 18 gusht në Bruksel, Kurti ka thënë se dialogu duhet të jetë për marrëveshje ligjrisht e obligueshme, për normalizim të plotë me njohje reciproke.

# Familja Dehari kërkon përjashtimin e prokurorit Shefkiu

PRISHTINË, 12 GUSHT - Familja Dehari ka shprehur pakënaqësi me punën e Afrim Shefkiut, prokuror, në rastin e vdekjes së ish-aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari. Pas katër vjetësh prej se rasti ndodhet nën hetime, familja e Astrit Deharit ka kërkuar shkarkimin e prokurorit Shefkiu. “Sot jemi në këtë konferencë lidhur me një kërkesë për përjashtimin e prokurorit special, Afrim Shefkiu”, ka thënë Tomë Gashi, përfaqësues ligjor i familjes së ish-aktivistit Dehari. Ndërsa Xhemile Dehari, nëna e Astritit, ka kritikuar Prokurorinë Speciale për mënyrën se si e ka trajtuar rastin. “Ai që katër vjet nuk na thërret kurrë. Nuk na lajmëron kurrë për një rast që ka

ndodhur në duart e tyre, të shtetit”, ka thënë Xhemile Dehari.

Në anën tjetër, Avni Dehari, babai i Astritit, ka thënë se prokurori Shefkiu nuk i është përgjigjur asnjë kërkesë të familjes dhe përfaqësuesit të saj ligjor Tomë Gashit.

Më 12 prill të këtij viti Prokuroria Speciale përmes një njoftimi për medie kishte bërë me dije se më 1 prill ka pranuar raportin nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës lidhur me rastin e Astrit Deharit. Sipas Prokurorisë, raporti i ekspertizës së Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit kishte konstatuar: “Analizat e AND-së, nga objektet që kanë qenë në kontakt me të



ndjerin Astrit Dehari, në momente të afërta me vdekjen (brisk rroje, stilolaps i lidhur me një lidhëse këpucësh dhe një pjesë metali) nuk kanë treguar profil të AND-së përveç të atij, Astrit Deharit. Analizat

toksikologjike plotësuese të gjakut periferik të Astrit Deharit kanë treguar praninë e kafeinës dhe mosprani të etanolit. Sa i përket ekshumimit të trupit të të ndjerit, nuk ka rekomandim në ekspertizë dhe e njëjta nuk

është rekomanduar që të riekzaminohet trupi duke pasur parasysh se sa kohë ka kaluar”. Prokuroria Speciale kishte njoftuar se do t'i vazhdojë hetimet deri në zbardhjen e plotë të rastit Dehari.



## Shefi i NATO-s në javën e ardhshme takohet me Kurtin dhe Vuçiqin

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të takohen në Bruksel javën e ardhshme, konkretisht të mërkurën. Po ashtu, është njoftuar se pas takimit Kurti dhe Stoltenbergu do të mbajnë një konferencë të përbashkët për medie në selinë e NATO-s. Po ashtu, shefi i NATO-s do të takohet edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Kujtojmë se këto takime zhvillohen pak javë pas tensioneve të krijuara në veri të

Kosovës. I pari i Qeverisë së Kosovës për tensionet në veri ka deklaruar se “përkeqësimi i grindjeve me serbët mund të rezultojë në një konflikt të ri”. Përveç Kurtit, rreth këtyre tensioneve kishte reaguar edhe Stoltenbergu, i cili kishte kërkuar që problemet të zgjidhen përmes dialogut dhe kishte thënë se NATO është e gatshme të ndërhyjë nëse rrezikohet stabiliteti. Ndërsa sa i përket takimit të Kurtit me shefin e NATO-s, ende nuk është bërë e me dije se për çfarë do të diskutohet.

## Presidenti i Shqipërisë të hënën viziton Kosovën

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, të hënën do ta vizitojë Republikën e Kosovës. Gjatë kësaj vizite, Begaj do të takohet me liderët institucionalë të

Kosovës. Në kuadër të kësaj vizite, Begaj do të takohet me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. “Të hënën, më 15 gusht 2022, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk

Konjufca, pret në takim presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj”, ka njoftuar Kuvendi i Kosovës. Kjo është vizita e parë e Begajt në Kosovë si president i Shqipërisë.



“Kam gatishmëri dhe interesim që dialogu në Bruksel, bisedimet aty, përveçse të jenë parimore dhe përmbajtjesore, në të njëjtën kohë të mos jenë dialog për dialog, por dialog për marrëveshje ligjrisht të obligueshme, për normalizim të plotë me njohje reciproke me qeveri. Por ju duhet ta kuptoni që marrëveshja bëhet me palën tjetër dhe në këtë rast varet nga

pala tjetër a do të ketë marrëveshje, ndërsa sa më përket mua, gatishmëria dhe interesimi janë të padiskutueshme dhe të palëkundshme”, ka thënë Kurti, pas një aktiviteti të Kuvendit për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë.

Ai ka thënë se reciprociteti është veprim i shëndoshë dhe normal i marrëdhënieve të mira

fqinjësore. “Ne po i marrim vendimet sovraane, por unë e kam thënë edhe në takimin e 15 qershorit të vitit të kaluar, edhe më 19 korrik të vitit të kaluar, se marrëveshja është e qëndrueshme dhe e zbatueshme. Kur ka parime të shëndetshme brenda, reciprociteti është veprim i shëndoshë dhe normal i marrëdhënieve të mira

fqinjësore”, ka deklaruar Kurti. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pritët të takohen në Bruksel më 18 gusht. Ky takim do të mbahet me kërkesën e Bashkimit Evropian dhe vjen pas tensioneve në veri të Kosovës, ku serbët e instrumentalizuar nga Beogradi zyrtar në fund të muajit korrik kishin vendosur

barrkada në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për reciprocitet për targa dhe dokumentet serbe. Vendimi i qeverisë për reciprocitet pritej të hynte në fuqi më 1 gusht, por për shkak të tensionimit të situatës në veri dhe me kërkesë të ShBA-së dhe BE-së, ky vendim është shtyrë për 1 shtator.

## Seminari i Gjuhës Shqipe, pa pjesëmarrës nga Rusia



PRISHTINË, 12 GUSHT - Në edicionin e 40 të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare nuk do të ketë pjesëmarrës nga Rusia, ka njoftuar drejtori i seminarit, Shkumbin Munishi. Edicioni i 40 i Seminarit të Gjuhës do të mbahet nga 15 deri më 26 gusht. Munishi ka treguar se këtë vit, për shkak të pushtimit rus të Ukrainës, kanë kërkuar nga institucionet që të marrin instruksione lidhur me atë nëse

duhet të lejohen të marrin pjesë shtetasit rusë. “Për fat të keq, dhe e konsideroj si gjë që nuk është aspak e duhur, ende nuk kemi marrë një përgjigje për këtë punë dhe praktikisht ne nuk u kemi kthyer përgjigje seminaristëve që tradicionalisht kanë ardhur nga Rusia”, ka thënë ai për “REL”-in. Munishi ka theksuar se ka parë që edhe shtete të tjera të Evropës kanë pezulluar pjesëmarrjen e shkollarëve dhe studentëve rusë në aktivitete të ndryshme, por ka thënë se me

lejimin ose jo të pjesëmarrjes së shtetasve rusë duhet të merren autoritetet e Kosovës. Në të kaluarën, në Seminarin e Gjuhës që mbahet në Prishtinë, kanë marrë pjesë profesorë të ndryshëm nga Rusia. Një ndër pjesëmarrësit në seminarin e kaluar ishte edhe albanologu rus Alexander Rusakov. Rusakov, profesor në Katedrën e Gjuhës Shqipe në Universitetin e Shën Petërburgut në Rusi, në një intervistë dhënë REL-it në mars të këtij viti, kishte thënë se lufta

e Ruisë kundër Ukrainës është “luftë kriminale”. “Është luftë kriminale nga ana e qeverisë sime, nga ana e Ruisë. Po, sepse është një luftë agresive kundër një shteti më të vogël që nuk paraqet asnjë rrezik për Rusinë”, kishte thënë ai. Vitin e kaluar në Seminarin e Gjuhës ishte edhe profesori i Gjuhës Shqipe nga Shën Petersburg, Aleksandar Novik. Atëbotë ai i kishte thënë se seminari ishte shumë i rëndësishëm pasi përkrah njohuritë për botën dhe

kulturën shqiptare. Seminari i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare është themeluar më 1974 në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. Seminari organizohet për studentët dhe studiuesit e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, por edhe për albanologjinë në përgjithësi. Kosova i është bashkuar Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, duke vendosur sanksione ndaj Ruisë pas nisjes së pushtimit të Ukrainës.

## Kurti për çështjen e shamisë: Mosha 16-vjeçare është pragu

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thyer heshtjen për çështjen e shamisë në shkolla. Ai ka thënë se nuk duhet të ketë ndalim të shamisë, mirëpo duhet të ketë një prag që, sipas tij, duhet të jetë mosha 16-vjeçare. “Ministria e Arsimit është duke e përcjellë me vëmendje shqetësimin e disa qytetarëve që e kanë nisur një fushatë. Ne do ta kemi edhe projektligjin për liritë fetare, për komunitetet fetare në Kosovë. Unë e kam thënë qëndrimin tim. Nuk duhet të ketë ndalim të shamisë dhe të elementëve të tjerë fetare në jetën publike të qytetarëve”, është shprehur Kurti, duke shtuar se nuk do të ishte keq që edhe në të ardhmen të votojnë edhe 16-vjeçarët. “Por, gjithashtu, mosha 16-vjeçare është pragu. Dhe mosha 16-vjeçare është pragu për shumë gjëra. Ky është qëndrimi im edhe si aktivist politik edhe si

kryetar i një subjekti. Meqë mund ta marrësh kartën e identitetit në moshën 16-vjeçare, besojmë që në të ardhmen e afërt nuk do të ishte keq që edhe mosha e votimit të ishte 16 vjeç. Ne e shohim moshën 16-vjeçare si moshë e pragut për shumë gjëra, e në këtë aspekt edhe për mbajtjen e shamisë”, është shprehur Kurti. Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, nuk ka dashur të komentojë mbi çështjen e hapur së fundi nëse duhet të hiqet udhëzimi administrativ që ndalon bartjen e shamisë në shkolla. Abdixhiku ka thënë se kjo është temë pa rëndësi që është prodhuar nga vetë pushteti për ta kamufluar “paaftësinë politike”. “Nuk e kam ndër mend të merrem me tema irelevante që prodhohen nga vetë pushteti për ta mbuluar paaftësinë qeverisëse të Kurtit”, ka thënë Abdixhiku.



## Ambasadorja izraelite impresionohet me punën në "Comodita"

GJAKOVË, 12 GUSHT (ER) - Ambasadorja e parë e Izraelit në Kosovë, Tammy Ziv, ka vizituar komunën e Gjakovës, ku është takuar me kryetarin e kësaj komune, Ardian Gjini. Pas takimit, ajo ka shprehur dëshirën t'i vizitojë edhe ambientet e fabrikës të shpuzës dhe dyshekëve "Comodita", ku është pritur nga menaxhmenti i kompanisë. Në këtë vizitë,

ambasadorja Ziv është befasuar me atë se çfarë ka parë në këtë fabrikë. Ajo është njoftuar nga menaxhmenti rreth sukseseve në eksport dhe gamën e gjerë të produkteve që ka "Comodita". Po ashtu, ajo kishte komente pozitive edhe rreth mënyrës se si funksionon "Comodita", duke filluar nga prodhimi i produkteve inovative, rregulli, pastërtia dhe numri i madh të grave të

punësuar, që e bën "Comoditën" kompani lidere, e cila kontribuon në fuqizimin e gruas në shoqëri. Në takim është diskutuar për mundësinë e rritjes së bashkëpunimit me bizneset nga Izraeli, ku mund të shkëmbehen përvoja nga të cilat mund të përfitojnë palët, duke e ditur që "Comodita" tashmë veçse është në tregun izraelit me prodhime.



## "Rinia do të jetë përherë brenda kombit në politikat tona qeveritare"



PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në seancën e organizuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Grupit i Deputetëve të Rinj në shënim të kësaj dite. Pas kësaj seance, kryeministri Kurti ka marrë pjesë në hapjen e panairit të iniciativave rinore në Republikën e Kosovës.

Kurti ka thënë se Kosova është me fat që ka numrin më të madh të të rinjve në Evropë. "Edhe pse jemi një vend jo i madh, ne kemi fatin të kemi numrin më të lartë të të rinjve në Evropë për popullsi të caktuar. Jemi të ndërgjegjshëm se disponojmë me të drejtë nga natyra talentin dhe energjinë e

shoqërive të përparuara, sepse të gjithë në këtë sallë e jashtë saj, jemi të bindur se talenti nuk njih shtetësi. Talenti njih vetëm seriozitet. Duhet të jemi seriozë me pjesën më energjike të shoqërisë sonë, me rininë", ka thënë Kurti, duke shtuar se të rinjtë do të jenë gjithmonë brenda politikave qeveritare. "E di që ka të rinj që kanë marrë botën në sy por, gjithashtu, e di edhe që shumë të rinj po kthehen nga bota në Kosovë dhe që të gjithë këta, qofshin në Kosovë ose në mërgatë, mund të jenë nganjëherë jashtë vendlindjes, por do të jenë përherë brenda kombit në politikat tona qeveritare e në angazhimet tona publike", ka thënë Kurti.


## Të rinjtë e Kosovës protestojnë me valixhe: Kur bohet mirë?

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Organizata "Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë", me sloganin "Kur bohet mirë?", ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Rinjve. Ky aktivitet është zhvilluar në sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë, ku edhe janë vendosur disa valixhe me emrat e personave që kanë ikur nga Kosova.

Rina Kadiri, menaxhere e programeve në këtë organizatë, ka thënë se për këtë ditë janë fokusuar në dukurinë e migrimit të të rinjve. Sipas saj,

për secilën valixhe të vendosur në rrugë është një histori.

"Secila valixhe ka një histori mbrapa. Kemi vënë mantele të bardha që tregojnë për mjekët që janë duke e lënë Kosovën për shkak se nuk i kanë mundësitë e duhura për punësim të tyre. Kemi vendosur flamuj që tregojnë për komunitetin LGBTI+, i cili nuk i ka dhe nuk i respektohen të drejtat bazë. Po ashtu, kemi vendosur edhe helmetat e punëtorëve që tregojnë që edhe punëtorët janë duke e lënë Kosovën. Ka simbolika edhe të tjera. Mbi të



gjitha kemi mbledhur edhe storie prej të rinjve shqiptarë, serbë, romë dhe të komuniteteve të ndryshme të Kosovës, të cilët e kanë treguar

ngjarjen e tyre pse po duan ta lënë Kosovën ose, ndoshta, dikush pse ka vendosur, pse mos ta lënë Kosovën. Kështu që ka histori të ndryshme dhe ju

kisha ftuar të gjithëve ta skanoni kodin, i cili është në secilën valixhe, për t'i lexuar historitë e të rinjve të Kosovës", ka thënë ajo.

Ndërsa Mehediye Dragusha nga Suhareka, e cila jeton në Gjermani dhe ishte pjesë e këtij aksioni, ka thënë se të rinjtë vijnë nga Kosova në Gjermani për shkak se nuk kanë vende të punës. "Ata nuk kanë vende pune në spitale, nuk pranohen. Juristi nuk pranohet, e lë e Kosovës sepse nuk ka vend pune. S'ka firma, s'ka fabrika", ka thënë ajo.

## BE-ja nga viti 2007 ka dhënë 85 milionë euro për rininë e Kosovës

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, ka vlerësuar se çelësi i zhvillimit të të rinjve është arsimiti. Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë ai ka bërë me dije se Bashkimi

Evropian (BE) ka dhënë 85 milionë euro nga viti 2007 deri në vitin 2022 për rininë e Kosovës. "Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë dua të theksoj se arsimiti është çelësi i zhvillimit! Kjo është arsyeja pse BE-ja vazhdon të investojë në

arsimimin e të rinjve në Kosovë. Nga viti 2007 deri në 2022 BE-ja ka investuar më shumë se 85 milionë euro në përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë në Kosovë", ka shkruar Szunyog në "Twitter".



# Kurti lavdëron punën e drejtuesve të doganës: Të hyrat u rritën për 14 për qind

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës dhe ministri i Financave, Hekuran Murati, kanë vizituar të premten Doganën e Kosovës, ku janë pritur në takim nga drejtori i këtij institucioni, Agron Llugaliu.

Kurti ka thënë se kjo vizitë është në shenjë falënderimi dhe mirënjohje për këtë institucion. Me këtë rast, ai ka deklaruar se rritja e të hyrave nga Dogana e Kosovës është 14 për qind më e madhe se në vitin e kaluar. Kurti ka thënë se vlera e konfiskimeve dhe sekuestreimeve për këtë vit ka shkuar në 5 milionë, nga 2 milionë sa ishte një vit më parë. “Unë jam i kënaqur që patëm një vizitë në Doganën e Kosovës. Kjo vizitë është mirënjohje dhe falënderim për udhëheqjen e Doganës. Policia dhe Dogana janë thelbi i sigurisë së shtetit tonë dhe kur kësaj sigurie i shtohen të mirat, atëherë nuk mund të themi se nuk shpreh gatishtëri më të shtuar në vijim. 14 për qind janë rritur të hyrat krahasuar me vitin e kaluar. Vjet kishim 2 milionë euro konfiskime, ndërsa këtë vit kemi pesë milionë euro.

Edhe besueshmëria te qytetarët për Doganën është rritur”, ka thënë Kurti, duke shtuar se matjet e fundit kanë treguar se besueshmëria e qytetarëve ndaj Doganës së Kosovës është rritur. “Një studim i Bankës Botërore ka treguar që edhe koha e zhdoganimit ka përmirësimit të madh në vlerën 36 për qind për import dhe 16 për qind për eksport, krahasuar me matjen paraprake, e kjo është tejet e rëndësishme për investitorët e huaj, në veçanti për ekonominë e Kosovës, për komunitetin e biznesit, i cili me këtë të dhënë padyshim që inkurajohet për t'i riinvestuar fitimet e kursimeve”, ka thënë Kurti.

Edhe ministri i Financave, Hekuran Murati, ka lavdëruar punën e Doganës së Kosovës, duke thënë se konfiskimet e mallrave të kontrabanduara ditët e sotme janë bërë “pothuajse të përditshme”. “Konfiskimet tashmë janë bërë çështje pothuajse të përditshme, ndërsa në të kaluarën rrallëherë është dëgjuar për to. Ky është mesazh për ata që provojnë të bëjnë kontrabandë. Është



mesazh që tashmë nuk është e mundshme një gjë e tillë dhe kushton shumë më shtrenjtë sesa të kalojnë në kanalet zyrtare. Për këtë falënderoj ekipin që është e angazhuar drejtpërdrejt në luftën ndaj kontrabandës në

Doganën e Kosovës”, ka thënë Murati.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka thënë se të hyrat në këtë vit janë më të larta se në vitin e kaluar. “Ne e njoftuam kryeministrin se

dogana vazhdon të ketë performancë më të mirë se vitin e kaluar. Këtë vit kemi të hyra 14 për qind më shumë se në vitin e kaluar. Gjithashtu, e njoftuam për rezultatin në mbrojtje të shoqërisë”, është shprehur Llugaliu.

## Transferohen 9 000 lëndë të bizneseve në Gjykatën Komerciale, në shtator seancat e para

PRISHTINË, 12 GUSHT - Me fillimin e punës së Gjykatës Komerciale bizneset do të kenë një adresë të vetme për të gjitha çështjet për të cilat kërkojnë mbrojtje gjyqësore. Lëndët e para pritet të shqyrtohen nga shtatori i këtij viti. Përfaqësues të bizneseve e kanë mirëpritur themelimin e kësaj gjykate, por njohës të ekonomisë kanë shprehur skepticizëm për punën e saj.

Tashmë mbi 9 000 lëndë janë transferuar në këtë gjykatë, ka bërë me dije për RTK-në, kryetari i Gjykatës Komerciale, Mahir Tutuli. Sipas tij, deri në plotësimin e plotë të numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës nuk do të jenë në kapacitetin e plotë të procedimit të lëndëve.

“Dhomat e shkallës së dytë e kanë më të lehtë procedurën, sepse nuk kanë seanca dhe mund të fillojnë menjëherë



punën pas pranimit të lëndëve. Problematika qëndron në Dhomat e shkallës së parë, sepse palët duhet të njoftohen lidhur me seancat tetë (8) ditë

para. Duke pasur parasysh që nuk kemi staf të kompletuar ende, duhet minimalisht diku dy (2) javë apo më shumë të dorëzohen ftesat. Prandaj

presim që seancat e para të fillojnë diku në fillim të shtatorit”, ka thënë Tutuli.

Ndërsa përfaqësuesi i bizneseve, Agim Shahini, ka thënë për Radio Kosovën se fillimi i punës së Gjykatës Komerciale është një siguri për bizneset dhe investitorët. “Kjo ofron siguri për investitorët vendorë dhe të huaj, që ata në të ardhmen mund t'i zgjidhin problemet ndërmjet operatorëve ekonomikë në një periudhë më të shkurtër 1-3 vjet, dhe jo si në të kaluarën kur u ka marrë kohë më shumë. Kjo ka qenë një kërkesë e kamotshme e AKB-së dhe e komunitetit të biznesit”, ka thënë Shahini.

Por, njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka shprehur skepticizëm për sa i përket funksionimit të plotë të kësaj

gjykate. “Biznesi në Kosovë meriton elemente të barrierave dhe demokracisë, meriton prurje të vendimeve të shpejta. Në këtë drejtim, uroj të ketë sukses, por gjithmonë e kam një dozë të skepticizmit sepse janë të njëjtët njerëz, është e njëjta traditë dhe fakti që e kemi këtë mungesë të përgjegjësive, qoftë edhe në ndarje, kam frikë se kjo do të jetë vetëm një mundësi për t'i punësuar dhe avancuar disa të punësuar në gjyqësi, dhe efektet do të jenë ato që na kanë përcjellë në të kaluarën”, ka thënë Gërxhaliu.

Sidoqoftë, Gjykata Komerciale është themeluar në fillim të këtij viti, ndërsa pritet t'i trajtojë të gjitha kontestet lidhur me çështjet ekonomike dhe konfliktet administrative në kontestet ekonomike.

## Më 19 gusht mbahet ankandi i letrave me vlerë

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 19 gusht 2022 do të mbahet ankandi i nëntë i letrave me vlerë për vitin 2022. Në këtë ankand do të

emtohen obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku

interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi.

“Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e

letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjëherë nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës”, ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.





# Shfaqja 388-vjeçare që vazhdon të jepet edhe sot

Nga: Laura Studarus / BBC

Kur e viziton Obëramergau, një fshat i vogël ky i vendosur në Alpet bavareze të Gjermanisë, ndihesh sikur po hyn në një film të "Disney"-t. Prej maleve të valëzuara që rrethojnë fshatin e deri te shtëpitë prej druri të mbuluara me piktura dhe gdhendje të artit popullor – një praktikë që atje daton që nga shekulli XVI – lehtësisht të vijnë fjalët "çuditshëm", "lezetshëm" dhe "e denjë për kartolinë". Nuk duket as e çuditshme as pse zona i ka aparatet e veta për shitje të verërave dhe të djathit ... sepse, pse të mos i inkurajojnë vizitorët që ta shijojnë sa më shumë këtë mjedis?

Pranë qendrës së fshatit gjendet kisha katolike baroke e Shën Pjetrit dhe Shën Palit. Pikërisht këtu, në vitin 1634, në këtë kishë të stilit rokoko për herë të parë fshatarët dhanë një zotim historik. Në një zhvillim ngjarjesh që sot përjetohet si jehonë e frikshme, murtaja e zezë preku fshatin dhe për vetëm pak muaj vrau pothuajse 20 për qind të banorëve. Në përpjekjen për ta ndryshuar këtë valë, banorët prematuan se një herë në 10 vjet do ta japin një shfaqje pasioni – i njohur si ritregim dramatik i jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezu Krishtit – nëse Zoti do ta kursejë pjesën tjetër të banorëve. Shfaqjet e para u dhanë në varrezat e kishës, pikërisht mbi trupat e të prekurve nga sëmundja, dhe – siç thotë historia – asnjë tjetër nuk vdiq.

Që prej shfaqjeve të para, shumë ngjarje ndikuan në ndalimin e shfaqjes që zakonisht luhet në fillim të çdo deкаде – përfshirë këtu Luftën Franko-Prusiane, Gripin Spanjoll dhe, po, Covidin-19, me realizimin e vitit 2020 që është shtyrë për këtë vit – e që si zakonisht jepet nga maji deri në tetor. Historikisht, ajo ka përjetuar edhe mbështetje të përzier: më 1770, Duka i Bavarisë – Maximilian III Joseph – u përpoq ta ndalonte, duke pretenduar se "skena e teatrit nuk është vend për sekretin më të madh të fesë tonë të shenjtë". Sidoqoftë, në vitin 1900, sipërmarrësi Thomas Cook e vërejt një vlerë të tillë te kjo shfaqje, sa që e detyroi komunën që ta ndërtojë një teatër me 4 400 vende, në mënyrë që të mund të silte aty audiencë të huaj me idenë për ta

parë një shfaqje pesë-orëshe (pa harruar pushimin tre-orësh për darkë) në një gjuhë që ata nuk e flisnin, një lëvizje kjo që me sukses e prezantoi turizmin në rajon.

Tashti, në vitin e 388-të, shfaqja e pasionit ndikon pothuajse në çdo aspekt të jetës në fshat. Gati 2 000 nga 5 000 banorët e Obëramergaut marrin pjesë si para ashtu edhe pas skenës. Aktorët kryesorë angazhohen për ta marrë pothuajse një vit pushim për punën gjatë provave, për një udhëtim grupor në Izrael dhe për orarin gjashtëmuor të shfaqjes. Dhe, çdo burrë kujdeset për rritjen e flokëve – një vit para shfaqjes – dhe i mban të çregullta derisa të priten gjatë festës së mbylljes (flokët e tyre më vonë shfaqen si litarë në Muzeun "Oberammergau", një ndërtesë e mbuluar me kostume të kaltra nga shfaqja e vitit 2000 dhe e vitit 2010 e "Pasionit").

Siç thotë Frederik Mayet, një nga dy aktorët e alternuar në rolin e Jezusit për këtë vit, të gjitha sakrificat grupore janë në shërbim të asaj që ata e shohin si e një e mirë më e madhe. Në fakt, për këtë gjatë ata janë trajnuar gjatë gjithë jetës së tyre. "Të vegjlit rriten në lojën e pasionit", thotë ai. "Janë vetëm disa muajsh më të vegjlit që për herë të parë dalin në skenë. Kënga e parë në shfaqjen e pasionit, kur Jezusi lëvizën hipur mbi gomar, është një këngë që të gjithë ne e mësojnë që në shkollë. Për herën e parë e kemi kënduar disa javë më parë [gjatë provave]. Pata mornica. Kam shumë emocione tash".

I gjithë kasti i "Passionsspiel" përbëhet nga amatorët. Megjithatë, 12 skenat e produksionit ndihen elegante. Në skenë shfaqen tufa të kafshëve shtëpiake, përfshirë gomarin që ndihmon në paraqitjen e parë të Jezusit. Dhe, çdo detaj i Dhiatës së Re, përfshirë Jezusin duke pastruar tempullin, duke kryer mrekulli, duke u ulur në darkën e fundit dhe në fund duke vdekur e duke u ringjallur, luhet me sinqeritetin që zemrën ta thyen. Mes akteve, tablotë statike të frymëzuara nga Dhiata e Vjetër që i përshkruajnë skenat që supozohet që në mënyrë specifike të përfytyrojnë ngjarjet që zhvillohen në historinë kryesore, e shtojnë nuancën e surrealistit. Gjatë skenave të mëdha të turmave, aktorët më të rinj fërfëllojnë kostumet e



veta dhe lëvizin nëpër skenë, duke e shtuar sensin e realizmit (duhet të dini se fëmijët e epokës biblike nuk e njihnin gjithmonë peshën e ngjarjes që dëshmonin). Por, asnjëra nga këto nuk e largon vëmendjen prej temës qendrore të shfaqjes. Shfaqja mund të jetë në gjermanisht (me manuskriptet që janë në dispozicion në anglisht), por edhe nëse nuk e flisni gjuhën, misioni është i qartë: ky është një akt pasioni.

Christian Stückl, drejtori artistik i Teatrit Popullor të Munihut i cili ka marrë përsipër shfaqjen e pasionit të vitit 1990 dhe që këtë vit e bëri regjinë për të katërtën herë, thotë se në shumë aspekte krijimi i saj është përvojë mjaft unike – por, në fund të fundit, shfaqja është shfaqje.

"Më pëlqen shumë të punoj me këta amatorë, këtu në Obëramergau", thotë ai. "Është krejt ndryshe nëse punoj me aktorët profesionistë në Munih. Në Obëramergau më duhet të dal në skenë dhe t'ju tregoj se si ta bëjnë. Aktorëve profesionistë nuk u pëlqen nëse hipi në skenë dhe tregoj diçka. Por, një amator ka nevojë për këtë. Tekefundit, nuk është aq ndryshe, sepse mund të kesh profesionistë të këqij dhe amatorë të mirë. Janë shumë afër njëri-tjetrit".

Gjatë kohës që është në krye, Stückl e ka parë shfaqjen gjithashtu duke kaluar nëpër një sërë ndryshimesh të dukshme administrative. Në vitin 1999 e realizoi me sukses një peticion që e hoqi rregullin që të gjithë aktorët duhet të jenë katolikë (edhe pse e quan si kufizues rregullin se duhet të lindësh në fshat ose të jesh banor 20-vjeçar, duke vënë në dukje se dy dekada janë shumë të gjata për të dëshmuar se je pjesë e qytetit). Megjithatë, të bësh

përshtatje në produksionin aktual kjo mund të jetë gjë e ndërlikuar kur keni të bëni me një traditë shekullore.

"Kemi shumë probleme me Obëramergau, sepse brezit të ri i pëlqen të ketë shfaqje të re dhe brezi i vjetër kapet për shfaqjet më të vjetra të pasionit", thotë Stückl. "Shumica e operatorëve turistikë thonë, 'jo duhet ta bësh të njëjtën gjë si 10 vjet më parë, sepse publikut tim i pëlqen ta shohë të njëjtën shfaqje'".


Megjithatë, pavarësisht shtyrjeve, evolucioni ka ndodhur. Të ftuarit VIP – përgjatë gjithë viteve – përfshijnë edhe Hitlerin i cili fatkeqësisht ishte adhurues i madh. Për shkak të kësaj, Stückl mendoi se është e rëndësishme të jetë i sigurt që të eliminohet çdo lexim potencial antisemitik i materialit. Duke pasur parasysh këtë, ndryshimet e bëra përfshijnë shtimin e një menorahu që tani vendoset në tryezë – gjatë darkës së fundit – ndërsa, në një moment, Jezusi e mban torën përpara audiencës ... të gjitha këto për të theksuar se Jezusi ishte hebre.

Mayet shpreson se përshkrimi i tij i Jezusit është gjithashtu i përshtatshëm për kohën. Ashtu sikur kur filloi shfaqja, bota është në trazira. Nëse Jezusi i "Pasionit" ka nevojë të bërtasë në mënyrë që të dëgjohet, atëherë ashtu qoftë.

"Duam ta kemi një Jezus që është shumë i sigurt në atë që thotë", thotë ai. "Pra, dikush që është shumë i zhurmshëm dhe që bërtet. Shumëçka ka ndryshuar në 12 vjetët e fundit. E kemi një situatë krejtësisht të ndryshme botërore. Të pasurit bëhen më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Dhe, në dy vitet e fundit e kemi pasur koronavirusin. Në vitin 2015 dhe

përsëri këtë vit e patëm krizën e refugjatëve në Evropë. Pra, është një nevojë e thellë që Jezusi përsëri të jetë më i zhurmshëm". Është e kuptueshme që kjo shfaqje e rrallë që jepet një herë në dekadë, është kthyer në pelegrinazh si për besimtarët – ashtu edhe për ata që thjesht e vlerësojnë një shfaqje epike. Si anëtarë të publikut, na pëlqen ta shohim pasionin, por ndoshta edhe më shumë jemi të tërhequr nga historitë familjare. Dhe, teksa është e lehtë të gjurmosh vizualisht ngjashmëritë gjenealogjike fizike midis aktorëve, shfaqja e pasionit të Obëramergaut është gjithashtu historia e "familjes së zgjedhur" – e një grupi njerëzish që ndajnë dashurinë dhe mbështetjen e thellë për njëri-tjetrin, pavarësisht se nuk janë biologjikisht të lidhur. Siç shpjegon banori dhe interpretuesi lokal Otto Huber (i cili qesh dhe thotë: "Më thonë se jam 75 vjeç", kur e pyesin moshën), është ai faktor që e ka shtyrë atë të marrë pjesë, vit pas viti – diçka që do të vazhdojë për aq kohë sa ka mundësi.

"Obëramergau është vend i mahnitshëm", thotë ai. "Është fantastike të shikosh Obëramergau me këtë shumëllojshmëri të evolucionit të artit, të muzikës dhe të teatrit. Është vërtet e mrekullueshme. Dhe, jemi mirënjohës që kemi mundur të jetojmë në këtë vend. Dhe, baza e çdo gjëje është ngrohtësia vëllazërore. Për fqinjët tanë kemi ndjesi shumë të mirë familjare. Paraardhësit e nënës sime erdhën në qytet qysh para vitit 1600. Dhe, ndonëse nuk i marrim marrë listat e roleve [që nga atëherë], jemi gjithmonë të përkushtuar ndaj shfaqjes". *Telegrafi/Përktheu: Agron Shala*



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita me synime të mëdha në kampionatin e ri

Trajneri Ardian Nuhiu dhe kapiteni Ardian Limani kanë thënë në konferencën për medie se Drita është e gatshme për edicionin e ri të futbollit dhe se ka synime të mëdha, ndërsa për ndeshjen e parë kundër Trepçës '89 kanë paralajmëruar fitore

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**GJILAN, 12 GUSHT** - Skuadra e Dritës nga Gjilani ka synime të mëdha në edicionin e ri të futbollit 2022/23, i cili fillon sot (e shtunë). Ky klub ka mbajtur të premtën konferencë për medie, ku të pranishëm ishin trajneri Ardian Nuhiu dhe kapiteni Ardian Limani. Trajneri Nuhiu ka thënë se pjesëmarrja në garat evropiane nuk do të diskutohet për klubin gjilanas. "Objektivat do të jenë ndeshje për ndeshje, duke fituar çdonjërin apo duke mos humbur asnjërin. Nuk

diskutohet që me një skuadër si kjo e jona me aq shumë potencial, me futbollistë cilësorë gjithmonë janë objektivat madhore. Evropa nuk duhet të diskutohet dhe gjithmonë të jemi rivalizues për ta fituar titullin. Nuk do të jetë aspak e lehtë sepse në garë nuk do të jemi vetëm, por do t'ia lëmë që në fund ta bëjmë numërimin dhe të shohim se çfarë do të na sjellë kampionati gjatë rrugës", ka thënë Nuhiu.

Në linjë të njëjtë me trajnerin është edhe kapiteni i skuadrës, Ardian Limani, i cili ka deklaruar: "Me padurim po e presim



fillimin e ri, vijmë pas paraqitjeve shumë të mira në Evropë, por ato tashmë i kemi lënë pas dhe duhet të fokusohemi te ndeshjet kampionale. Duhet ta fillojmë mirë, sepse një fillim i mirë do të thotë një kampionat i mirë. Duhet t'i qasemi ndeshje pas ndeshje në të njëjtin nivel sikur

ndeshjet e Evropës dhe gjithmonë për fitore dhe për objektivat e klubit". Ndeshjen e parë skuadra e Dritës e zhvillon kundër Trepçës '89 në Mitrovicë. Lidhur me këtë ndeshje, Nuhiu ka deklaruar: "Na pret një skuadër që gjithmonë meriton të jetë në Superligë, sepse ka dëshmuar

gjithmonë cilësi. Ata kanë ruajtur grupin dhe jorastësisht janë rikthyer, por mendoj se skuadra jonë është gati dhe është e rëndësishme ta bëjmë maksimumin të gjithë që ta nisim kampionatin mbarë". Kapiteni Ardian Limani për ndeshjen e parë të edicionit të ri ka thënë se përballja me 89-shin gjithmonë është e vështirë, por Drita synon fitore. "Na pret një ndeshje e vështirë, sepse në Mitrovicë ka qenë gjithmonë e vështirë, prandaj duhet të shkojmë me seriozitet maksimal. Jo vetëm të shtunën, por në çdo ndeshje në kampionat duhet të hyjmë për fitore. Nëse me këtë skuadër futesh për një rezultat tjetër, pos fitores, atëherë kemi dështuar që në fillim. Mendoj se mentaliteti i skuadrës sonë ndër vite është krijuar me synim fitoren", ka deklaruar Limani.

## Reja: Po punohet mirë me moshat, Shqipëria ka futbollistë premtues

**Tiranë, 12 gusht** - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edoardo Reja, ka ndjekur të dyja miqësoret e ekipeve kombëtare kuqezi U-18 dhe U-19 që zhvilluan ndaj bashkëmoshatarëve të Italisë më 10 dhe 11 gusht në qendrën e Korverçanos në vendin fqinj. Duke analizuar paraqitjet e këtyre ekipeve, tekniku shprehet se ishin teste të rëndësishme ndaj një rivali mjaft të fortë siç është Italia. Përtej rezultateve të miqësoreve, sipas Rejës, lojtarët e grumbulluar treguan gjëra të mira dhe premtojnë për të ardhmen nëse do të punohet mirë me moshat dhe t'u jepet të rinjve e gjithë mbështetja e duhur. "Pashë gjëra pozitive në këto dy miqësore,



sidomos në aspektin e temperamentit djemtë kanë bërë gjëra të mira në fushë, ndonëse u mundën që sigurisht ka një rëndësi relative në miqësore, por kanë qenë vazhdimisht në lojë dhe kanë luftuar. Sigurisht, vlerat e të dyja skuadrave të Italisë janë superiore në aspektin fizik, janë të gjithë lojtarë në qendër të vëmendjes në Itali dhe të afirmuar

në klube të mëdha, edhe pse janë shumë të rinj. Në këtë kuptim është gati e pamundur të pretendosh t'i mposhtësh, por gjithsesi të dyja ekipet shqiptare treguan shumë gjëra të mira gjatë miqësoreve", ka thënë Reja për FShF-në, teksa vlerëson faktin se këto përvoja janë mjaft të vlefshme për ta analizuar situatën ku jemi dhe objektivin ku duam të shkojmë. "Për shembull në ndeshjen mes Kombëtareve U-19, Shqipëria në 30 minutat e para luajti si e barabartë, madje edhe në pjesën e dytë tregoi futboll interesant në fushë. Ne përpiqemi gjithmonë të përmirësohemi sepse këto përvoja janë të rëndësishme për të bërë

krahasime, por ka edhe elementë interesantë në këto dy grupe. Duhet ta pranojmë që Italia ka një brez të shkëlqyer të vitlindjes 2005. Unë mbeta i kënaqur që pata mundësinë t'i shoh ekipet kombëtare në aksion dhe konstatoj se lojtarët japin shenja përmirësimi të vazhdueshëm", ka shtuar tekniku kuqezi, duke theksuar se ka shumë elementë premtues dhe në të ardhmen ne duhet të jemi edhe më kompetitivë në raport me rivalët e tjerë evropianë. "Ka shumë elementë të mirë në të dyja grupmoshat. Është një grup me të cilin po punohet mirë, ndërkohë që po ndjekim rritjen e këtyre lojtarëve, një pjesë e të cilëve i kam

ndjekur edhe më parë në ekipet zinxhir të moshave. Ka edhe shumë lojtarë të tjerë të rinj që aktivizohen në klubet shqiptare dhe më kanë krijuar përshtypje të mira. Mund të them se po punohet mirë në futbollin e të rinjve në Shqipëri. Ne duhet të synojmë që në të ardhmen të jemi më shumë kompetitivë dhe objektivit është që të rivalizojmë skuadra të tjera, pasi është e vështirë të matesh me ekipe si Italia, Anglia, Gjermania apo Franca, por nëse punojmë mirë mund të konkurrojmë denjësisht me skuadra si Polonia, Austria, Kroacia apo Çekia dhe të luajmë si të barabartë me ekipe të këtij niveli", ka deklaruar Reja.

## Drilon Tahirukaj transferohet në elitën e Zvicrës

**DEÇAN, 12 GUSHT** - Aloja e Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Drilon Tahirukaj, ka bërë lëvizje shumë të rëndësishme në karrierë. Tahirukaj karrierën e vazhdon në elitën e Zvicrës, saktësisht në skuadrën Kreuzlingen.

Kreuzlingeni e ka zyrtarizuar angazhimin e alos së djathtë, që tashmë ka nisur stërvitjet në Zvicër. Pjesë e kësaj skuadre janë edhe shumë reprezentues të Kosovës, duke filluar nga kapiteni Valon Dedaj, pastaj Bujar Ramosaj, Haris Berisha



dhe Drenit Tahirukajt. Dreniti është vëllai i Drilonit. Të gjithë këta janë shumë të rëndësishëm për Përfaqësuesen e Kosovës. Kreuzlingeni për herë të parë do të luajë në Superligën e Zvicrës. Drilon Tahirukaj në edicionin e kaluar luajti për skuadrën e

Deçanit, vendlindjes së tij. Për shumë edicione 26-vjeçari ishte pjesë shumë e rëndësishme e Besa Famgas, me të cilën skuadër ka fituar shumë trofe. Kalimi i Drilonit në Zvicër është lajm pozitiv edhe për Kosovën në prag të sfidave të ardhshme.

## Rodney Purvis përforcon Pejën

**PEJË, 12 GUSHT** - KB Peja ka arritur pajtim me njërin ndër lojtarët më të mirë në Kosovë sezonin e kaluar, Rodney Purvis. "Rodney Purvis i bashkëngjitet projektit tonë për sezonin

2022/23. Purvis më herët kishte luajtur në ligën e ëndrrave, në NBA për ekipin Orlando Magic, ndërsa vitin e kaluar ndihmoi shumë Trepçën në arritjen deri në finale", thuhet në njoftimin e

skuadrës së Pejës. Nga klubi pejan të enjten është larguar basketbollisti më i mirë në vend, Dardan Berisha, kurse si përforcim ka ardhur edhe amerikanin Isiah Umipig. Ky i

fundit ka një përvojë të gjatë në NCAA, Sllovakia, Kanada, Turqi, Lituani, Ukraine dhe në sezonin e fundit ishte pjesë e Ligës elite të Zvicrës, tek ekipi BBC Nyon.



## Piloti i Ferrarit: Për herë të parë kam hyrë në Maranello nga dera e pasme

Madrid, 12 gusht - Hera e parë nuk harrohet kurrë. Nëse monogasku Charles Leclerc ka mbërritur për herë të parë në Maranello (fabrikën e Ferrari) në moshën 12-vjeçare, piloti

tjetër i makinës italiane, spanjoli Carlos Sainz, ka pasur një tjetër aventurë. Në vitet 2019 e 2020 ai garoi me McLaren dhe, siç tregon vetë spanjoli, kur u paraqit në dyert e Maranellos, ai ishte

ende nën kontratë me makinën britanike. Për pasojë, në bazë të rregullave të Formulës 1, ai nuk mund të shkonte në një skuadër tjetër deri më 1 janar. "Hera e parë që shkova te Ferrari

ishte një mision sekret. Duhej të prisja që të skadonte kontrata ime me ekipin e mëparshëm. Në fund, vendosëm që të hyja nga dera e pasme e Maranellos", ka thënë Sainz,



## Krasniqi emërohet drejtor sportiv i FC Prishtina

PRISHTINË, 12 GUSHT - FC Prishtina ka nisur që të marrë pamje të re në javët e fundit. Pas emërimit të presidentit të ri të klubit, Hakif Gashi, klubi "bardhekalter" së fundmi e ka emëruar edhe drejtorin e ri sportiv. Kjo pozitë i është besuar ish-futbollistit të mirënjohur të ekipit, Driton Krasniqi. Ish-mesfushori vjen nga qyteti i Prishtinës dhe si futbollist ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ekip duke i fituar të gjithë titujt e mundshëm në futbollin e Kosovës me Prishtinën. "Driti" ka bërë karrierë në Kosovë edhe te KEK-u, kurse në Shqipëri te Besa e Kavajës, Tomori i Beratit dhe Shkumbini i Peqinit, me ç'rast me Besën është paraqitur në më shumë se 20 ndeshje në garat evropiane. 37-vjeçari është paraqitur si drejtor i ri i Prishtinës nga presidenti Hakif Gashi, ndërkohë që për faqen zyrtare të klubit, FC Prishtina e ka dhënë një intervistë, ku i ka shpalosur synimet që i ka me ekipin e tij të zezës. "Të jem i sinqertë, nuk e kam menduar fare që në këto momente të rikthehem në klub, por pasi që është emëruar president Hakif Gashi dhe me propozimin e



aksionarit Rrahman Haradini, iu bashkova projektit të ri të klubit. Dua që me këtë rast t'i falënderoj për besimin që e kanë shfaqur ndaj meje dhe do të mundohem maksimalisht që të punoj në arritjen e synimeve që i kemi si klub", ka thënë Krasniqi. "Rikthimi? Janë bërë gjashtë vjet që jam larguar nga klubi fizikisht, mirëpo me mendje dhe me zemër kam qenë gjithmonë këtu. Pozita e drejtorit sportiv është shumë e rëndësishme dhe do ta jap kontributin tim që të kemi sa më shumë suksese së bashku", ka shtuar Krasniqi. Ish-kapiteni i kryeqytetasve ka folur edhe për synimet që ka me skuadrën e tij të zezës. "Do të punojmë shumë në vazhdimësi jo vetëm në këtë edicion, mirëpo edhe në të ardhmen që ta formojmë një Prishtinë shumë të fortë jo vetëm për Kosovë, por edhe për Evropë. Objektivat e klubit sa i përket

Kosovës dihen dhe nuk kanë nevojë që të përmenden", ka deklaruar ai. Në fund, Krasniqi ka falënderuar edhe ish-presidentin e klubit të Prishtinës, Remzi Ejupin dhe aksionarin e madh Rrahman Haradini. "Së pari dua që ta falënderoj ish-presidentin Remzi Ejupi, i cili për shumë dekada e vite ka dhënë gjithçka për klubin tonë e shpresoj se të njëjtën gjë do ta bëjë edhe nga pozita e aksionarit. Dua që me këtë rast ta falënderoj edhe presidentin e ri Hakif Gashi, të cilit i dëshiroj suksese dhe kam besim të fuqishëm në projektin e tij dhe punën e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme. Aksionari tjetër Rrahman Haradini ka qenë një ndër të palodhshmit e klubit dhe në çdo moment i është gjendur afër Prishtinës edhe në ditët më të vështira dhe në këto momente po jap gjithçka së bashku me presidentin e ri, tashmë në një rrugëtim të përbashkët. Qëllimi është që të gjithë së bashku me vetëm një qëllim, ta bëjmë një Prishtinë të madhe ashtu siç i ka hije e ndërrojnë qytetarët e kryeqytetit dhe jo vetëm", ka përfunduar Krasniqi.

### SHKURT

#### Kupa e Botës nis një ditë më herët

Kupa e Botës do të nisë një ditë më herët. Byroja e Këshillit të FIFA-s konfirmoi ndryshimet në lidhje me Kupën e Botës që ishin propozuar ditët e fundit dhe që paraqesin një ndryshim të rëndësishëm në kalendar. Si fillim, turneu do të nisë të dielën, më 20 nëntor dhe jo me datën 21, siç ishte planifikuar më parë. Gjithashtu, ndeshja hapëse do të jetë Katar-Ecuador, në vend të Holandë-Senegal, që ishte parashikuar pas hedhjes së shortit në fillim të muajit prill. Ky ndryshim nënkupton një nisje të Kupës së Botës me festë më të madhe, pasi është vendi pritës ai që do ta hapë turneun.

#### Unitedi nuk lejon Rashfordin t'i bashkohet PSG-së

Manchester Unitedi është i përkushtuar ta mbajë Marcus Rashfordin në "Old Trafford" për sezonin 2022-2023 pavarësisht interesimit nga Paris Saint-Germaini. Sipas "ESPN", Unitedi nuk ka ndër mend ta shesë Rashfordin këtë verë. Raporti, gjithashtu, thekson se "Djajtë e Kuq" janë shumë të interesuar për ta vazhduar kontratën me sulmuesin anglez.

#### Unitedi dhe Galatasaray shprehin interesim për Icardin

Sulmuesi argjentinas Mauro Icardi nuk është më pjesë e planeve të PSG-së dhe trajneri Galtier e ka bërë të qartë faktin se argjentinas duhet të kërkojë një klub të ri ose përndryshe do të luajë me ekipin e dytë të francezëve. Sipas "Tyc Sports", sulmuesi ka tërhequr vëmendjen e Manchester Unitedit dhe Galatasarayt, të cilët të dyja janë të interesuar për një huazim me të drejtë blerjeje. Gjithashtu, edhe Monza në Serinë A ka kohë që është në kontakte me Icardin.

#### Sterlingi tregon pse u largua nga City: Nuk më pëlqen të qëndroj në stol

Raheem Sterling ka shpjeguar së fundmi për mediet londineze arsyet e largimit nga Manchester City dhe pse iu bashkua Chelseat këtë verë, duke zbuluar se ai nuk ishte i gatshëm ta pranonte stolin. "Ishte momenti për t'u larguar nga Manchester City. Kuptova se nuk isha më në qendër të projektit dhe nuk kisha pse të qëndroja. Nëse nuk largohesha, do të bëja një gabim shumë të madh në karrierën time. Kam dhënë gjithçka nga vetja te City dhe unë jam një person që dua të rritem, jo të shoh të tjerët si luajnë. Unë dua ende të luaj, të shënoj dhe të fitoj në të ardhmen. Duhej një sfidë e re dhe Chelsea ishte skuadra e duhur. Jam i lumtur që jam këtu", ka thënë sulmuesi anglez. Chelsea shpenzoi plot 47.5 milionë paund këtë verë (57 milionë dollarë) për Sterlingun dhe sulmuesi debutoi me Evertonit (0-1) në transfertë.

## NBA tërheq përgjithmonë numrin 6 për nder të Russellit

BOSTON, 12 GUSHT - NBA ka marrë një vendim historik, duke tërhequr përgjithnjë fanellën me numër 6 për nder të Bill Russell, njeriut më të suksesshëm në historinë e këtij sporti. Ai ndërroi jetë pak kohë më parë në moshën 88-vjeçare, një ikonë e këtij sporti në vitet '50-'60. Vendimi për ta tërhequr fanellën me numër 6 ka vlerë për 30 skuadrat e NBA-së (Russell ka luajtur vetëm me Boston Celticsin). Gjithsesi, të gjithë lojtarët që kanë mbajtur këtë numër sezonin e kaluar (25 në total) e mes tyre edhe LeBron



Jamesi, do të vazhdojnë ta mbajnë këtë numër nëse dëshirojnë. Por, në të ardhmen, asnjë ekip nuk do të mund të japë më këtë numër derisa të vijë një ditë që askush të mos e mbajë

numrin 6. Për të përkujtuar Bill Russellin dhe numrin 6 që ai mbante, çdo ekip i NBA-së do të mbajë në shpatullën e djathtë një trifletësh me numër 6 mbi të sezonin e ri. Komisionari i NBA-së, Adam Silver, ka deklaruar: "Suksesi i Russellit në fushë dhe si pionier për të drejtat civile meriton të nderohet në mënyrë unike dhe historike. Duke tërhequr përgjithnjë numrin 6 në të gjithë Ligën, çka tregon se karriera e Billit do të kujtohet përgjithnjë". Propozimin për tërheqjen e numrit 6 e pat dhënë Magic Johnsoni.

## Trajneri i PSG-së: Të gjithë e duan Messin

Trajneri i Paris Saint-Germainit, Christophe Galtier, lavdëroi Lionel Messin, pasi u pyet se si ndihej teksa menaxhon ikonën e Argentinës. Galtier zëvendësoi Mauricio Pochettino në krye të PSG-së.

"Nuk mund të befsohem sa i mirë është ai sepse kur ke një rekord të tillë, një numër të tillë ndeshjesh, aq trofe, është sepse je një profesionist shumë i madh. Ai e ka konfirmuar atë menjëherë për mua. Leo bën të

gjitha seancat stërvitore, është i përfshirë, është i buzëqeshur, shkëmbehet me partnerët, është frymëzim për lojtarët tanë dhe më pëlqen çdo moment ta shoh në fushë, ta përshëndes çdo ditë sepse

përfaqëson shembullin që duhet ndjekur", ka thënë fillimisht Galtier. "Ai ka fituar gjithçka, thjesht i ka munguar Kupa e Botës, por në nivel klubesh ai ka fituar gjithçka. Ai ka fituar çmime individuale,

por nuk është i kënaqur, larg kësaj. Unë mendoj se ai është i lumtur dhe kur Leo buzëqesh, skuadra buzëqesh. Ai është i dashur dhe i admiruar nga bashkëmoshatarët e tij", ka shtuar trajneri i PSG-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Nr:558/1

Dt: 12.08.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### RI-SHPALLJE E KONKURISIT

**Për plotësimin e vendeve të lira dhe zëvendësimin Qendrën e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2022/2023**

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Dy (2) mësimdhënës/e për lëndët e teoritike dhe praktike në drejtimin e tekstilit, profili: konfeksion (me nga 20 orë mësimore)	Zëvendësimi deri në kthimin e mësimdhënësve nga pushimi i lehonisë
			Një (1) punëtorë/e teknik-pastrues (40 orë pune në javë)	Vend i lirë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranohet udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës në Skenderaj dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim nëse keni përvojë;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkathtësi të lartë integriteti;

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën punëtor teknik

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtese të cilat i ndan drejtori i shkollës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkathtësi të lartë integriteti,

#### Aftësitë shtesë

- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues si dhe personelit të Shkollës.

Paga: koef 4

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

#### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Sh. A, Prishtinë, ka obligim shërbimin - largimin e mbeturinave për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit në Prishtinë si dhe në njësitë rajonale Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan, Drenas dhe Kastriot.

Për të përmbushur këtë obligim me sukses dhe cilësi, kërkohet angazhim maksimal dhe bashkëpunim.

Në mënyrë që t'ju ofrohet ky shërbim me cilësi, kërkohet nga Ju që të përmbushni obligimin tuaj – pagesën e faturave.

KRM "Pastrimi" Sh.A, duke filluar nga data 15 Gusht 2022, do të fillojë me procedimin e konsumatorëve borxhlinj (për konsumatorët me borxhe të akumuluar ndër vite), në Procedurë Përmbarimore tek Përmbaruesi Privat.

Inicimi i kësaj procedure përmes Përmbaruesit Privat, krijon taksën shtesë.

Për t'ju shmangur kësaj procedure, kërkohet nga Ju që sa më parë ta përmbushni obligimin tuaj ndaj KRM "Pastrimi" Sh. A, ndryshe, jemi të detyruar ta dërgojmë lëndën në Procedurë Përmbarimore.

Faleminderit për bashkëpunimin!

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "M& E Production Management" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810099368.

► "M-Company" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr.70471307.

► Simoni nga Pjetershani kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Anton Qeta" Dol KK Gjakovë.

► Genti Albert Lota nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë dega në Gjakovë me nr. 1184/14.

► Valbone Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Yll Morina" Gjakovë nga kl. I-VIII.

► Albert Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

► Angjelina Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

